
Flutura e nënës sime

Teksa motra zbriste shkallët e shtëpisë, përkrye portës u dha një flutur e kaltër, me pika të lehta bojëgruri, e bukur magji. Praruar nga rrezet e diellit në perëndim, zhytej fashave të dritës, flatronte mbi kokat tona, fshikte krahët mureve, tavanit, kanatave.

Motra mbajti frymën.

- Tataja! - belbëzoi e mallëngjyer.

Lot malli vezulluan faqeve të rreshkura.

U kthye majë gishtave, hapi derën. Flutura u derdh korridorit, përshkoi kuzhinën, kryqëzoi këmbët e vogla *mbi oxhak*, u rrotullua të orientohej. Kërceu mbi perden e dritares së lumit, vështroi cazë matanë ballkonit, ktheu kokën, sikur donte ta thoshte diçka me gjuhë flatrash. Njihthe çdo qoshe të fshehtë nga ato që ne me zor i shquanim. Fëshfëritja e krahëve u ngrit mbi heshtjen misterioze, muzikë e ëmbël pikuar prej qiellit, çau cipën e hollë të plagës dhe ajo zuri të pikojë gjak. Zemra m'u mblodh lëmsh. Si ia kisha dalë dhjetë vjet të ndrydhja mallin për nënën time, si dreqin kisha qeshur e bërë shaka, ndërsa ajo prehej në varrezat e qytetit? *Krijesa bojëgruri pruri jehonën e një kohe të artë, kur Tataja i jepte jetë shtëpisë*. Vitet rrëshqitën mbrapsht, zëri melodioz vërshoi lumë i rrëmbyer pas shirave litar të pranverës, a jehonë ardhur nga lart, të kallëzonte përrallat e fëmijërisë...

Sa histori të vjetra zhytur humbellës së moteve tregonte nëna ime e mençur, thua ndrynte në mish, eshtra e gjak të fshehtat e botës të cilat nuk i shteri një jetë të tërë! Njihthe majë gishtave çdo shtëpi, arë e rrugë mbushur dëngëza me ngjarje, si qenë dikur e si ndryshuan vragave të kohës, dinte çdo varr të vjetër, sheshuar prej kohës, se njerëzia harruar pas punëve të përditshme i patën lënë pas dore. Mbante mend kullat e Jasharit senenë kur i për lau përroi i fryrë për qamet si të mos qenë kurrë, e dinte ku e pati shtëpinë xha Seli dhe ku e ndërtoi më vonë, i kujtohej hakmarrja e Spahinjve me kolonelin e frëngut që deshi të çnderonte Nadiren, çupën më të bukur të fshatit.

Ledhatonte një rrënjëz domate të shkelur, ngulte sytë diku, harkonte vetullat, para se të dëftente bëmat e çuditshme, ku fantazia ime prej fëmije mezi depërtonte. Personazhet imagjinare lëvrinin nga Guri i Kamjes e Valamara te guvat e Malit të Thatë, nga brigjet e rrëpira të Shkumbinit te Liqeni i Ohrit. Rrëfimet mbanin aromën e barit të kositur ku pluskon era e luleshtrydheve, kundërmimin e dheut kthyer nga parmenda, fërfërimën e pikave të shiut në të mbaruar të ditës. Peizazhet kishin ngjyrat e ftoit të lulëzuar, lulekaçeve të porsaçelura, gjetheve të arrës ngjyer në të gjelbër. Mbushej me frymë të çlodhej dhe tok me fjalët fironin bota e stisur, e bukura e dheut, divi, ariu i kafenjtë. Ndërsa vija e ujit, kopshti i vaditur, filizi i drejtuar i domates ishin aty njëlloj si më parë, mendja ime e njomë orvatej të kuptonte si i ia dilte arra të ngjyente një më një tërë ato fletë!

E sëndisja sa s'thuhet me kureshtjen time të mallkuar, po tinës vija re se në një farë mënyre e çlodhja nga andrallat. Shpesh s'kishte nge, sajonte aty për aty përralla të reja, ose fillonte nga e para të vjetrat, të më hiqte qafe.

- Më nxori nga mendtë! - e dëgjova t'i thoshte një mbrëmje hake Këzes, - bëra si bëra çalltisa një, po do ti humba fillin. Ai s'dha e mori, e vazhdoi gjer në fund pa gabuar, ke parë kështu malukati?

Bari i kositur livadheve, yjet kupës qiellore, oshtima e erës zemrës së dimrit, kënga e përrenjve gufuar nga bora e shkrirë e gazmonin. Harmonia e botës, paqja, mirësia njerëzore ishin parime e saj më të larta. Nuk njihja tjetër të prekte aq fisnikërisht zogun e rrëzuar nga shtrofulla, një filiz të çapëlyer kumbulle, këmbën e kalit të plagosur, nanuritur me shprehje hirplote si të qenë

fëmijët e saj. Ku i gjente tërë ato fjalë? Si ia dilte të shkërbente njërin pas tjetrit zërin e çjerrë të sprijës së ligë, pastaj pëshpërimën e ëmbël të engjëllit? Si arrinte të bënte bashkë fjalët e njerëzve me hungërimat, mjaullitjet, bulurimat e kafshëve? Sa dua ta dëgjoj tani atë zë plot ngjyra, të shijoj pamjen e ëmbël prej nuseje me sy të perënduar nga dhuntia e rrëfimit!

I mësova një për një përrallat me xhinde, katallanë, botën e nëndheshme të vdekatarëve, historitë e burrave zulmëmëdhenj që vulosën dikur fatet e vendit. Të folurit e pleqve, zërin e ngjirur të kapedanit, britmat e komitëve, i mbajta mend gjer vonë, pa ditur se do të më hynin aq shumë në punën time të ardhshme. Kur shkruaj, ndiej vështrimin e syve të saj prej qiellit dhe ngutem të mbush faqet njëren pas tjetrës. E shtrenjta nënë më dha leksionin e parë të letërsisë.

Librat e mi mbajnë huret e saj...

Tetë vjet s'u mësua me qytetin, thua pati ardhur mikeshë për pak kohë, priste të kthehej atje ku i bënte shpirti rehat. Dilte në ballkon, kulloste sytë maleve ku gjelbëronte lisi, rrugëve mbushur me kalimtarë, masës stërmadhe të ujit në liqen.

- Pashë xha Minin sot, - tregoi një mbrëmje, - ishte plakur e kërrusur i shkreti, ama u çmalla, sikur solli një grusht dhe' fshati poshtë ballkonit.

Sytë i ndrisnin nga gëzimi.

Të nesërmen kërkoi ta shpinim në fshat.

- Sa të çmallem me njerëzit, - psherëtiu e menduar.

- Nja dy-tre ditë, - i thashë buzagaz.

- Epo çdo të rri më shumë! - u gjegj serioze.

Mbështetur krahut të motrës u ra kryq e tërthor udhëve të fshatit, bekoi me ujë e kripë varret e të parëve, takoi moshatarët pakësuar së tepërmi viteve të fundit. Sytë e mbushur binin të malluar mbi njerëzit, shtëpitë, kasollet, të mbjellat. Çdo fillim gushti vinte me babanë të shinin thekrën në Kozic, qëndronin dy javë larg shtëpisë. Tani nuk ngjitej dot ta shihte për herë të fundit. Lot të nxehtë iu mblodhën nën mjekër.

Në mbrëmje zuri vendin e dikurshëm pas trungut të arrës së madhe, plasaritur e zgavruar nga vitet. Dielli në të perënduar lyente me purpur bashkat e reve, tisi ngjyrë bronzi ndehej si njëherë e një kohë mbi giethnajën vigane, fladi erëmirë ia ledhatonte cullufet mikeshës së vjetër. Kushedi sa herë pati kuvenduar aty me moshataret, kushedi sa herë patën qeshur e qarë me gazet e brengat e jetës. Tani shumica preheshin në pllajën me tuma dheu matanë lumit, të gjallat rrëgjuar pleqërie, nuk çapiteshin dot gjer te arra. Sytë e mjegulluar nga lotët u endën skutave ku rrinin atëherë. Tikua hundëmadhe shtrohej mbi koritën kthyer përmbys, pinte duhan, nuk linte njeri pa ngarë. Këzja ulur në bisht për qosh trungut numëronte dertet e pambaruara.

Befas iu bë se Ishka pas saj, lëvizi vendit, i vuri dorën në pëqi.

- Erdhe, tata Selviko? Të kemi pritur, na mbetën sytë udhës së qytetit!

S'pati fat e zeza, burrë sa për të thënë, një e dy çapin aty e mbante, nxirrte gulçin.

- Ç't'i bësh! - bashkoi dorën më të sajën, - ky qe fati yt.

- Pse kaq i hidhur?

- E de, mjaft u qave, ka më keq.

- Ashtu xhanëm! - fshiu hundët me mëngën e fustanit.

- S'e paske harruar zakonin, sa herë të kam thënë? Tuhaf njeri mbete!

- Uh, harrova, ama dhe ti!

- Për të mirën tënde e kam.

- Mirë të thotë, - e ngau Këzja, - na e shpife!

- E de, mirë, oj po kjo!

Qeshën të gjitha.

- Sheqere, ti je moj derëbardhë? Sa më paska zënë malli! - iu kthye rrënjës së dalë të arrës, ku rrinte duarkryq me sytë përdhe.

Ajo tundi kokën si t'i thoshte:

- Unë që mos qofsha, hanko Selviko!

- Si nuk fole njëherë, vetëm dëgjo e qesh.

- Tani s'mundem, - iu bë të përgjigjej Sheqerja.

- Epo s'ke se si!

Ajri kërciste, thua shpirtrat e uritur nga malli orvateshin ta ceknin me duar prej ajri. Dhe s'kishin faj, i la të prisnin gjatë!

- Ndjesë paçin, - ngriti zërin, - sa të mira ishin!

Ku ta dinte ç'i ndodhi? Ndoshta mosha bënte të vetën, ndoshta shpirti i ngazëllyer në atë perëndimi të hatashëm dielli u bë njësh me to.

Përkëdheli me sy siluetat e mbledhura për hatrin e saj, rregulloi shaminë, i vuri dorën në sup së bijës, zverdhur gjethe ftoi.

- Se si m'u duk, - u shfajësua, - thua erdhën vërtet!...

Në krye të javës nuk më nxinte shtëpia, një lëmsh në fund të barkut më pengonte të merrja frymë lirisht. Pse kërkoi ta shpinim *edhe njëherë atje*? Pse ndenji aq gjatë? Mos përfundoi në varreza dhe nuk donin të më thoshin? Mora gjithë ankth rrugën e fshatit ta shtija edhe njëherë ndër sy. Përfund arës së lumit shqova siluetën e drejtë, supet e ngritura, floknajën verdhashe dhe më vajti zemra në vend. Ecte sa ecte, ndalonte pak, bënte më tej të merrte sa më shumë mbresa.

Motra e ndiqte kokëvarur.

Vrapova sa do ta kishte zili çdo kampion atletike, i hodha krahët rreth qafës, i futa kokën në gji, e nuhata...

E pamundur të ngopesha, sikur edhe e kisha edhe s'e kisha aty.

- Ngadalë, ore, më mbyte! - qeshi me masë.

Si më pa të zbehur, e kuptoi.

- Mos bëj kështu, ja ku e ke nënën tënde. S'i kam mbaruar të gjitha punët e kësaj bote, tërë ata nipa e mbesa pa martuar!

Nuk ia vura veshin.

- Erdha të marr, - i thashë.

M'i hodhi sytë e bukur, të lodhur.

- Prit ore, të çmallem cazë, ku dihet çka shkruar Zoti?

- Mjaft sivjet, ja erdhi moti, - zvarrita fjalët sa më qetë munda.

Nuk i thashë se mezi e shtyva një javë, se po të ikte andej nga e thërriste s'di se kush, do të marrosesha, se ishte përtej mundësive të duroja...

Ende kërthi, një mëngjes gushti në valën e punëve, u gdhiva aq sëmure, sa të gjithë ma hoqën fillin, përveç saj.

- Nuk do të vdesë, - u tha motrave.

Ato prenë të qarat...

- Pse aq e sigurt? - e pyeta vite më vonë.

- E pashë në sytë e tu, - u përgjigj gjysmë me shaka, - nuk vuaje nga ndonjë sëmundje, hidhje vickla si mushkat se të lashë vetëm atë ditë...

Njëlloj si atëherë më dhembte trupi, më çanin kockat, mendja më vinte rrotull, s'isha as në qiell, as në tokë.

I erdhi keq, ma mori kokën në gji, siç bënte gjithnjë në vogëlinë time.

- Po ti qenke prush, o bir!

Përfshiu me sy të rrëmbushur shtëpinë, pusin, arrën, bahçen e mollëve gjer tutje ku arrinte vështrimi. Ia kishte ënda të rrinte edhe ca, të çmallej me njerëzit, dheun, varret e të afërmve, po unë e desha të tërën për vete.

Rëndova më tepër.

- Njeriu s'ngopet kurrë me vendin e tij, - psherëtiu.

Sa u kthye zuri shtratin. Humbi gjallërinë e dikurshme, bebëzat iu çngjyrosën. E gdhinte me sytë tretur rrugës së Tiranës, ku qëllonte të vonohesha me tim vëlla.

- Do të vinë, ke për të parë, - i jepte kurajë gruaja.

Lutej me vete të kishte të drejtë.

- Ah, moj bijë, nënë mos qofsh, veç për keq shkon mendja.

Ktheheshim, i vinte çehreja, na prekte duart e ngrira nga të ftohtit e janarit.

- Sa i ëmbël evlati! - pëshpëriste me zë të mpakur...

Flutura ndaloj mbi supet e motrës, nguli këmbët leshrave, përplasi krahët të ruante ekuilibrin. Sa herë matej të ngrihej fluturim, ndërronte mendje, kthehej t'i terte lotët.

Nuk i ndava sytë...

Ditën fatale erdhëm afër mëngjesit. S'u ankua, lëvizi paksa kokën, na vështroi me sy të shuar. Thirrëm ambulancën, e zumë për krahësh të zbrisnim shkallët. Këmbët mezi i hidhte, më shumë e mbanim peshë.

- Pret makina! - e nguta.

Shpejtoi pak hapin, më hodhi sytë e murrëtuat, sikur donte të thoshte:

" S'e shikon si jam katandisur, o bir? "

Ato fjalë më gjëmojnë në vesh sot e kësaj dite. Si nuk telefonova të mos e gdhinte natën në ballkon atij janari të acartë?! Si nuk më shkoi mendja ta shpija më parë te mjeku? Përse vonova aq shumë?

- E le pas dore, - më tha atëherë shoku im Kimi.

Desha t'i shkrehesha, po sakaq e kuptova, sytë e tij të çiltër thoshin të vërtetën! Dhjetë vjet mbajta mbi shpinë barrën e rëndë të fajit. Qava, thirra si i marrë, përplasa kokën pas oxhakut pa kurrfarë dobie.

Guri i fajit u fundos thellë e më thellë.

Plaga zuri kore...

I thashë vëllait të njoftonte motrën e madhe në Tiranë. Ajo ngriti sytë ta shihte, thua do t'i vinte atij çasti. Si nuk e pa, u ndeh pa frymë, mbylli sytë. U mblodhëm gjithë sa ishim, e përmendëm. T'i kishte ardhur Shqipja, do të mbaronte, nuk mund të ikte pa e parë për herë të fundit.

Tërë natën në jerm, jepte e merrte.

Ne qanim fshehtas.

- Nuk do ta shohim më kurrë, - çau heshtjen një zë i ngashëryer.

Gruaja ime u sul jashtë, duke shkukur leshrat.

Ne, pjellat e saj, që as guxonim ta sillnim në mendje vdekjen, u dorëzuam. Motrat dilnin një nga një, mekeshin së qari diku, ktheheshin me bebëza flakë të kuqe.

Tataja i diktoi, nuk u mashtrua as tani në grahmat e fundit.

- Mos ikni, - u tha me ndërprerje zëri, - dua t'u shoh, s'kam kohë.

Kaloi sytë nga motra e madhe te vëllai, i fundit i fëmijëve.

- I vogli i nënës, - lëvizi buzët mundimshëm të prapmen herë.

Mbylli sytë..

Flutura kaltëroshe fëshfëriti krahët u ngrit, më preku shkarazi llërën, iku si të kishte përmbushur misionin e vet qiellor. Vitet s'paskëshin bërë tjetër përveçse të zbërdhulnin së kujtimet si fotografitë e vjetra në mur. Malli kishte marrë fytyrën e pritjes. U plasa në dysHEME, e qava përsëdyti të bukurën time leshraflori. Motra fshiu lotët me cep të shamisë, u qas, mbështeti dorën supit tim, më ledhatoi me dashurinë e vet dhe nënës përzier së toku.

- E zuri malli, pa u kthye, - pëshpëriti e përmalluar, - të qe zemëruar nuk vinte.

Po unë nuk e mblidhja dot veten...

E diel, 14 shkurt, 2021
